



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 626/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.09.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave lidhur me skualifikimin e operatorit ekonomik “Trinity Trade Company” shpk nga procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-29384-07-04-2019, me objekt: “Blerje uniforma për Policinë Bashkiake”, me fond limit 1,563,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 17.07.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Ankimues: “Trinity Trade Company” shpk
Adresa: Rruga “Reshit Collaku”, Nd 38, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Durrës
Adresa: Sheshi “Liria”, Durrës.

Subjekt i Interesuar: “Euro 2001” shpk
Adresa: Rruga “Re e Trenit”, Lagjja Hekurudha, Elbasan.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky operator ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05.07.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-29384-07-04-2019, me objekt: “Blerje uniforma për Policinë Bashkiake”, me fond limit 1,563,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 17.07.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 17.07.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 30.07.2019 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Denisa Beshaj”	1,253,000 lekë	skualifikuar
2. “Trinity Trade Company”	1,274,600 lekë	skualifikuar
3. “Euro 2001”	1,333,600 lekë	kualifikuar
4. “Blerina Sadiku”	1,343,360 lekë	kualifikuar
5. “Malbertex”	1,359,560 lekë	skualifikuar
6. “Gjergjeffi”	1,497,800 lekë	kualifikuar
7. “Paera”	1,522,600 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 30.07.2019, operatori ekonomik “Trinity Trade Company” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyen se:

- Ofertuesi “Trinity Trade Company” shpk me vlere te ofertes 1,274,600 leke, nuk ka përmbushur kërkesat për kualifikim te kerkuara ne dokumentat e tenderit e konkretisht:
 - Ne DST, pika 2.3 “Për kapacitetin teknik”, germa “a”, kerkohet: Furnizimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë prej 625'000 lekë, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit; Dëshmitë për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë: -Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ent publik, duhet të paraqesë Kontratë/Kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre ose/dhe fatura tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. -Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet te paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Operatori ekonomik “Trinity Trade Company” shpk per Furnizimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë prej 625'000 lekë, ka paraqitur kontrata me ent publik dhe fatura me sektorin privat, dhe kryesisht konsistojne ne furnizime me materiale ene kuzhine per kopesh, veshje per punonjesit e sherbimit sanitar dhe perparese laboratoresh per universitetin “Asleksander Xhuvani” Elbasan, furnizime me thase per Posten Shqiptare, furnizime me materiale mbrojtese nga kimikate te rrezikshme dhe fatura furnizimesh me pajisje te ndryshme per punetore. Ofertuesi “Trinity Trade Company” shpk ne asnje rast nuk ka paraqitur furnizime te ngjashme, uniforma për Policinë Bashkiake ose te ngjashme me to, si p.sh. uniforma policie, uniforma ushtrie, uniforma zjarrefikse e te tjera si keto. KVO vendos qe ofertuesi “Trinity Trade Company” shpk te mos kualifikohet.

II.4.1. Në datën 01.08.2019, operatori ekonomik “Trinity Trade Company” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor ku kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me skualifikimin e tij nga kjo procedurë prokurimi në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë vijon:

Shoqeria “Trinity Trade Company” shpk, ka marre pjese ne kete tender, duke derguar oferten e saj dhe dokumentat shoqeruese, nepermjet SPE, sipas kerkesave te DT, LPP dhe VKM- se per RRPP. Me date 30.07.2019, nepermjet SPE, na vijne 2 mesazhet e KVO-se, se AK Bashkia Durrës. Nepermjet mesazhit te pare njoftohemi per klasifikimin e Ofertuesve, si me poshte:

1.	“Denisa Beshaj”	1,253,000 lekë	skualifikuar
2.	“Trinity Trade Company”	1,274,600 lekë	skualifikuar
3.	“Euro 2001”	1,333,600 lekë	kualifikuar
4.	“Blerina Sadiku”	1,343,360 lekë	kualifikuar
5.	“Malbertex”	1,359,560 lekë	skualifikuar
6.	“Gjergjefi”	1,497,800 lekë	kualifikuar
7.	“Paera”	1,522,600 lekë	skualifikuar

ku shohim qe oferta e shoqerise tone eshte refuzuar.

Nepermjet mesazhit te dyte njoftohemi per “arsyen” e refuzimit, qe sipas KVO-se perkatese eshte:

- a) “Ofertuesi “Trinity Trade Company” shpk, nuk ka permbushur kerkesat per kualifikim te kerkuara ne dokumentat e tenderit, e konkretisht, Kapacitetin teknik, germa “a”, ku kerkohet: Furnizime te meparshme te ngjashme ne nje vlere prej 625,000 leke te realizuara gjate 3 viteve te fundit. Deshmite per furnizimet e meparshme, te ngjashme, duhet te vertetohen me dokumentacionin si me poshte:
- Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me ent publik, duhet te paraqese Kontrate/Kontrata te nenshkruara te shoqeruara me vertetim per realizimin e tyre ose/dhe fatura tatimore te shitjes ku te shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.
 - Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin privat, duhet te paraqese vetem fatura tatimore te shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.

Ne si kompani ofertuese, duke qene te bindur ne oferten tone e cila eshte e plote dhe e sakte me te gjitha dokumentat shoqeruese te saj, te cilet jane ne perputhje me DT dhe Ligjin, dhe te bindur ne ndonje gabim apo lapsus ose shkelje te Ligjit nga ana e KVO-se per s’kualifikimin tone, po bejme kete Ankese, fillimisht drejtuar AK. Ne mbeshtetje te Ligjit, sqarojme sa me poshte vijon:

Per sa i perket Arsyes se s’kualifikimit sqarojme:

Ne DT, tek kerkesat per kualifikim, kapaciteti teknik, pika 2.3.a kerkohet:

- Furnizimet e meparshme, te ngjashme, ne nje vlere prej 625,000 leke, te realizuara gjate 3 (tre) viteve te fundit; Deshmite per furnizimet e meparshme, te ngjashme, duhet te vertetohen me dokumentacionin si me poshte:
- Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me ent publik, duhet te paraqese Kontrate/Kontrata te nenshkruara te shoqeruara me vertetim per realizimin e tyre ose/dhe fatura tatimore te shitjes ku te shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.
- Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin privat, duhet te paraqese vetem fatura tatimore te shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.

Sipas Shtojces 10 te DT, Sasia dhe Grafiku i levrimit, te artikujve qe kerkohen jane keto:

Nr	Artikulli	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Kostume	copë	20		
2	Xhiboks	copë	20		
3	Pantallona verore	copë	64		
4	Pantallona dimërore	copë	64		
5	Këmishë me mëngë të shkurtra	copë	32		
6	Këmishë me mëngë të gjata	copë	32		
7	Kollare	copë	32		
8	Kapele verore	copë	32		
9	Kapele uniforme	copë	20		

10	Emblema kapele	copë	32		
11	Emblema krahu	copë	32		
12	Këpucë dimerore	copë	32		
13	Këpucë verore	copë	32		
14	Pulovra	copë	20		
15	Bluza	copë	64		
16	Rripmesi	copë	32		
17	Rrip Ceremonial	copë	6		
18	Kostum Ceremonial	copë	6		
19	Atlete uniforme	copë	20		
20	Elektrik i thjeshtë	copë	6		
21	Elektrik neutralizues	copë	4		

Ne nenin 27, pika 3 te VKM-se nr. 914, date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar, “Kontratat e Mallrave”, parashikohet se “Kerkesat e vecanta te kualifikimit duhet te perfsihjne te gjitha kriteret specifike, ne perputhje me nenin 46 te LPP. Kriteret duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates. Ne cdo rast, autoriteti kontraktor duhet te percaktoje dokumentet konkrete qe duhet te paraqesin operatoret ekonomike per permbushjen e ketyre kriterëve”. Ne nenin 27 pika 4 te VKM-se nr. 914, date 29.12.2014 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar, “Kontratat e Mallrave” parashikohet shprehimisht se: “Per te provuar pervojen e meparshme, autoriteti kontraktor kerkon deshmi perfurnizimet e meparshme, te ngjashme, te kryera gjate tri viteve te fundit. Ne cdo rast, vlere e kerkuar duhet te jete ne nje vlere jo me te madhe se 40% te vleres se perlllogaritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tri viteve te fundit. Autoriteti kontraktor si deshmi per pervojen e meparshme kerkon vertetime te leshuara nga nje ent publik ose/dhe fatura tatimore te shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara. Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin privat, si deshmi pranohen vetem fatura tatimore te shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara. Shoqeria jone, ne plotesim te kesaj kerkese te DT, si dhe ne mbeshtetje te neneve te siperpermendura te VKM-se, ka paraqitur, disa kontrata dhe fatura tatimore me artikuj te njejte dhe te ngjashem me artikujt e ketij tenderi, vlere e te cilave e tejkalon shume here vleren 625,000 leke pa tvsh te kerkuar ne DT.

Konkretisht kemi paraqitur:

1. Faturen nr.126, dt. 24.11.2017, shitur subjektit Ë-Center, ne te cilen vetem artikulli i njejte: - “Kepuce” ka vleren 4,073,300 leke pa tvsh.
2. Faturen nr. 124, dt. 21.11.2017, shitur subjektit Ë-Center, ne te cilen kemi artikujt e njejte: - “Elektrik dore” me vlere 1,138,500 leke pa tvsh; - “Kapele me strehe” me vlere 1,243,242 leke pa tvsh; dhe artikujt e ngjashem per uniforme: - “Jeleke fosforeshent” me vlere 591,000 leke pa tvsh; - “Pelerine shiu” me vlere 2,250,000 leke pa tvsh; - “Dorashka” me vlere 2,094,200 leke pa tvsh; - “Perparese” me vlere 319,600 leke pa tvsh.

3. *Faturen nr. 123, dt. 08.11.2017, shitur subjektit Ë-Center, ne te cilen kemi artikullin e ngjashem; - "Kaska" (per policine) - me vlere 1,406,174 leke pa tvsh.*
4. *Kontraten nr.1879/2, dt. 25.10.2018 me Universitetin e Elbasanit, me artikullin e njejte: - "Pantallona" me vlere 102,000 leke pa tvsh; dhe artikujt e ngjashem: Perparese, kominoshe, doreza me vlere 211,100 leke pa tvsh;*
5. *Kontraten nr.1837, dt. 27.06.2016 (realizuar 26.07.2016) me me Autoritetin Portual Durres me objekt "Pajisje Speciale per FSPD (policia e sigurise portuale)", shoqeruar me vertetim realizimi dhe fature me artikujt e njejte: - "Rrip mesi" me vlere 194,000 leke pa tvsh; - "Elektrik dore" me vlere 136,000 leke pa tvsh; Dhe artikujt e ngjashem: Pranga, shkopinj gome dhe paralizues (per polici), me vlere 453,000 leke pa tvsh;*
6. *Dy kontrata me Posten shqiptare me thase te konfeksionuara (te ngjashem me uniformat e konfeksionuara te kerkuara ne kete tender) me vlere: 4,534,180 leke pa tvsh;*
7. *Kontraten nr.1846, dt. 19.04.2017 me Bashkine Kolonje shoqeruar me vertetim realizimi dhe fature me artikujt te ngashem: dysheke, batanije, carcafe, jasteke (te konfeksionuara) me vlere: 557,500 leke pa tvsh;*
8. *Kontraten nr.1837, dt. 27.06.2016 (realizuar 26.07.2016) me QGTKRR- EL me artikujt e njejte: Xhakete dhe pantallona me vlere 40,000 leke pa tvsh dhe artikujt te tjere te ngjashem: Perparese, doreza etj me vlere mbi: 258,600 leke pa tvsh.*

Totali i te gjithë ketyre furnizimeve te njejta dhe te ngjashme me mallrat objekt prokurimi arrin vleren 19,532,396 leke pa tvsh, mbi 30 here me shume se vlera e kerkuar 625,000 leke.

Pra:

Autoriteti kontraktor nuk mund te pretendoje zera te ngjashem apo te njejte per te gjithë zerat e pasqyruar ne shtojcen "Sasia dhe Grafiku i Levrimit" te dokumentave te procedures pasi nje gje e tille te çon drejt percaktimit te zerave te njejte te mallrave, ne kundërshtim kjo me rregullat e prokurimit publik si me siper cituar. Nje percaktim i tille qe ne vetvete nenkupton eksperiencia te njejta apo zera te njejte te sherbimeve/puneve publike apo mallrave, bie ne kundërshtim edhe me vete frymen dhe qellimin e ligjit te percaktuara ne nenin 1 te tij, duke frenuar konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomik dhe duke bere nje trajtim jo te barabarte dhe diskriminues te ketyre operatoreve ekonomik pjesemarrës ne procedurat e prokurimit publik. Nga verifikimi qe do te kryeje KSHA, duhet te konstatoje se me ane te dokumentacionit te mesiperme te dorezuar, "Trinity Trade Company" shpk ka deshmuar se nga ana e tij jane here shitje te artikujve sipas preventivave ne shtojcen 10 "Sasia dhe grafiku i levrimit" te dokumentave standarte te tenderit objekt ankimi, referuar faturave tatimore dhe kontratave te mesiperme me autoritete te ndryshme kontraktore te cilat jane te shoqeruara me fatura dhe te pranuar nga autoritetet kontraktore. Mallrat objekt prokurimi te kerkuara nga autoriteti kontraktor jane artikuj kryesisht te konfeksionuara dhe jo vetem, me sasite perkatese per cdo produkt. Referuar objektit dhe preventivave te kontratave dhe faturave te mesipercituara rezulton se keto kontrata dhe fatura jane te realizuara me sukses dhe ne perputhje me afatet e percaktura. Referuar deshmive te eksperiences se meparshme te dorezuara dhe te realizuara nga "Trinity Trade Company" kemi provuar se kemi furnizuar mallra te cilat per nga natyra jane te njejta dhe mallra te ngjashme me objektin e procedures se prokurimit. Ne drejtim te

deshmise se eksperiencas se meparshme, te ngjashme me objektin e procedures se prokurimit, per autoritetin kontraktor eshte e rendesishme te provohet qe operatori ekonomik zoteron eksperiencat e meparshme te ngjashme me objektin e prokurimit. Sa me siper, autoriteti kontraktor nuk duhet te gjykoje ne menyre siperfaqesore e formale, par te analizoje ne themel dhe ne menyre te arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatet, ne funksion te qellimit dhe rrethanave faktike per te cilin vendosen kriteret e percaktuara. Interpretimi i kontratave te paraqitura nga "Trinity Trade Company" shpk nese do te cilesohet si eksperience e ngjashme duhet pare ne raport me natyren e mallrave dhe elementeve konkrete te realizimit te tyre qe autoriteti kontraktor synon te arrije te kryeje pas lidhjes se kontrates me operatorin ekonomik te klasifikuar te suksesshem. Ne rastin konkret, neni 46 pika 1 gerrna "b" e ligjit nr. 9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, eshte vertetimi i eksperiencas se meparshme te operatorit ekonomik pjesemarrës ne proceduren e prokurimit. Me ane te dokumentacionit te dorezuar ne SPE, "Trinity Trade Company" shpk ka vertetuar se ka kryer me sukses, fumizime te ngjashme ne perputhje me perqindjen e kerkuar nga autoriteti kontraktor, (40 % te vleres se fondit limit te kontrates se prokuruar).

Ne funksion te qellimit kryesor i cili eshte realizimi i kontrates me cilesi, KVO-ja e AK, duhet te kishte vleresuar ne fryrnen e LPP. Ne kete moment, KSHA-ja, duhet te veproje ne mbeshtetje te Ligjit sipas percaktimeve te mesiper shenuara si dhe per orientim duket te shohe edhe disa vendime te KPP-se per raste te ngjashme, si prsh: V/KPP. Nr 852/2018, dt 19.12.2018, me nr. prot. 1766 dt.22.11.2018; V/KPP. Nr 228/2018, dt 20.04.2018, me nr. prot.385 dt.28.02.2018; V/KPP. Nr 332/2017, dt 22.05.2017, me nr. prot.640 dt.03.04.2017.

PRA, pretendimi i KVO-se, per arsyen e s'kualifikimit tone, eshte i inxituar, i gabuar dhe i pambeshtetur ne Ligj, dhe duhet rrezuar nga ana e KSHA-se.

Perfundimisht:

-Me dokumentacionin e paraqitur, rezulton se shoqeria "Trinity Trade Company" sh.p.k eshte i afte te dorezoje produktet e kerkuara nga autoriteti kontraktor. Gjithashtu ajo konfirmon se eshte ne gjendje te dorezoje produkte sic eshte kerkuar nga autoriteti kontraktor ne specifikimet teknike te dokumentave te tenderit, gje e cila vertetohet plotesisht sipas dokumentacionit te paraqitur nga OE. -Gjithashtu sqarojme se ne baze te nenit 62 "Detyrimet gjate zbatimit te kontrates" te LPP, autoriteti kontraktor ka nje rol te posacem, per vete cilesimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe pergjegjesi thelbesore per realizimin e suksesshem te kontrates. Referuar rregullave te prokurimit publik, eshte pikerisht autoriteti kontraktor ai qe duhet te monitoroje zbatimin e kontrates, per t'u siguruar nese cilesia e mallit do te jete e njejte me cilesine dhe specifikimet teknike te premtuar ne oferte dhe te percaktuar ne kontrate. -Ne rast te shkeljes se kushteve te kerkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara ne kontrate, apo detyrimet, ne mbeshtetje te nenin 62 te LPP-se.

Pra, nisur nga teresia e dokumentave qe ka paraqitur shoqeria jone si dhe nga fryma e nenit 1, pika 2 LPP:

2. Qellimi i keli ligji eshte:

- a) te rrise eficencen dhe efikasitetin ne procedurat e prokurimit publik, te kryera nga autoritetet kontraktore;
- b) te siguroje mireperdorim te fondeve publike dhe te ule shpenzimet procedurale;
- c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedural e prokurimit publik;
- ç) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike;
- d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjilhe operatoret ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik;
- dh) te siguroje integritet, besim publik dhe transparence ne procedurat e prokurimit publik.

Si dhe vkm-se per RRPP, konklidojme qe oferta jone duhet pranuar nga AK.

Kerkojme nga titullari i AK:

Anullimin e vendimit te KVO-se mbi skualifikimin e shoqerise "Trinity Trade Company" shpk, duke e kualifikuar ate.

II.4.2. Me shkresën Nr. 7351/2 prot, datë 01.08.2019 autoritetit kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues ku ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues "Trinity Trade Company" shpk, nga autoriteti kontraktor.

II.4.3. Në datën 02.08.2019 operatori ekonomik ankimues "Trinity Trade Company" shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 13064/1 prot., datë 19.08.2019, protokolluar me tonën me numër 1356/2 prot., datë 21.08.2019, me objekt "Informacion" është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Trinity Trade Company" sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, me arsyetimin se *Operatori ekonomik "Trinity Trade Company" shpk per Furnizimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë prej 625'000 lekë, ka paraqitur kontrata me ent publik dhe fatura me sektorin privat, por ne asnje rast nuk ka paraqitur furnizime te ngjashme, uniforma për Policinë Bashkiake ose te ngjashme me to, si p.sh. uniforma policie, uniforma ushtrie,*

uniforma zjarrefikse e te tjera si keto. KVO vendos qe ofertuesi “Trinity Trade Company” shpk te mos kualifikohet”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në Shtojcën 8/2, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.a “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

a. *Furnizimet e mëparshme, të ngjashme, në një vlerë prej 625'000 lekë, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit; Dëshmitë për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me ent publik, duhet të paraqesë Kontratë/Kontrata të nënshkruara të shoqëruara me vërtetim për realizimin e tyre ose/dhe fatura tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

-Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar mesektorin privat, duhet te paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

III.1.2. Në shtojcën 10, “Specifikimet teknike”, në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar sasinë e mallit si më poshtë:

Nr	Artikulli	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Kostume	copë	20		
2	Xhiboks	copë	20		
3	Pantallona verore	copë	64		
4	Pantallona dimërore	copë	64		
5	Këmishë me mëngë të shkurtra	copë	32		
6	Këmishë me mëngë të gjata	copë	32		
7	Kollare	copë	32		
8	Kapele verore	copë	32		
9	Kapele uniforme	copë	20		
10	Emblema kapele	copë	32		
11	Emblema krahu	copë	32		
12	Këpucë dimerore	copë	32		
13	Këpucë verore	copë	32		
14	Pulovra	copë	20		
15	Bluza	copë	64		
16	Rripmesi	copë	32		
17	Rrip Ceremonial	copë	6		
18	Kostum Ceremonial	copë	6		
19	Atlete uniforme	copë	20		
20	Elektrik i thjeshtë	copë	6		
21	Elektrik neutralizues	copë	4		
	Totali				

	Tvsh 20%				
	Totali me Tvsh				

Afatet e lëvrimit të mallrave brenda 30 ditëve.

Afati i garancise: 1 vit, sipas specifikimeve teknike.

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në Sistemin e Prokurimeve Elektronikë (SPE), konstatohet se operatori ekonomik “Trinity Trade Company” sh.p.k., për plotësimin e kriterit të mësipërm, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. Kontratë Nr. ---- Prot., datë 28.12.2018 lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Qendrës së grumbullimit dhe trajtimit të kimikateve të rrezikshme, Elbasan dhe operatorit ekonomik “Trinity Trade Company” sh.p.k. me objekt “Blerje paisje të mbrojtjes individuale etj, për nevojat e Q.G.T.K.RR., Elbasan”, me fond limit total e 967.640 lekë pa TVSH.

- Faturë Tatimore Shitje me nr serie 71682617, datë 21.01.2019, bashkangjitur dhe preventive, shitës “Trinity Trade Company” sh.p.k. dhe blerës Qendra e grumbullimit dhe trajtimit të kimikateve të rrezikshme, Elbasan.

2. Kontratë Nr. 2773/18 Prot., datë 16.02.2017 lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Posta Shqiptare sh.a dhe operatorit ekonomik “Trinity Trade Company” sh.p.k. me objekt “Per blerjen shiritave plastikë për thasët me numerator dhe thasë”, me fond limit total 3.321.252 lekë pa TVSH.

- Vërtetim për realizim kontrate, Nr. 2345/2 Prot., datë 15.08.2017, lëshuar nga autoriteti kontraktor Posta Shqiptare sh.a.

- Faturë Tatimore Shitje me nr serie 44691164, datë 28.03.2017, bashkangjitur dhe preventivi, shitës “Trinity Trade Company” sh.p.k. dhe blerës Posta Shqiptare sh.a.

- Faturë Tatimore Shitje me nr serie 44691166, datë 14.04.2017, bashkangjitur dhe preventivi, shitës “Trinity Trade Company” sh.p.k. dhe blerës Posta Shqiptare sh.a.

3. Faturë Tatimore Shitje me nr serie 44691186, datë 08.11.2017, bashkangjitur dhe preventivi, shitës “Trinity Trade Company” sh.p.k. dhe blerës W Center.

4. Faturë Tatimore Shitje me nr serie 44691187, datë 21.11.2017, bashkangjitur dhe preventivi, shitës “Trinity Trade Company” sh.p.k. dhe blerës W Center.

5. Faturë Tatimore Shitje me nr serie 44691190, datë 24.11.2017, bashkangjitur dhe preventivi, shitës “Trinity Trade Company” sh.p.k. dhe blerës W Center.

6. Kontratë Nr. 1837 Prot., datë 27.06.2016 lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Autoriteti Portual Durrës dhe operatorit ekonomik “Trinity Trade Company” sh.p.k. me objekt “Pajisje special për FSPD”, me fond limit total 1,621.000 lekë pa TVSH.

- Vërtetim për realizim kontrate, Nr. 63 Prot., datë 01.03.2017, lëshuar nga autoriteti kontraktor Autoriteti Portual Durrës.

- Faturë Tatimore Shitje me nr serie 09097192, datë 26.07.2016, bashkangjitur dhe preventivi, shitës “Trinity Trade Company” sh.p.k. dhe blerës Autoriteti Portual Durrës.

7. Kontratë Nr. 4014/10 Prot., datë 15.02.2018 lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Posta Shqiptare sh.a dhe operatorit ekonomik “Trinity Trade Company” sh.p.k. me objekt Loti II “Blerje Thasë”, me fond limit total 4.178.964 lekë pa TVSH.

- Faturë Tatimore Shitje me nr serie 58230289, datë 10.04.2018, bashkangjitur dhe preventivi, shitës "Trinity Trade Company" sh.p.k. dhe blerës Posta Shqiptare sh.a.

8. Kontratë Nr. 1846 Prot., datë 19.04.2017 lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Bashkia Divjakë dhe operatorit ekonomik "Trinity Trade Company" sh.p.k. me objekt "Blerje pajisje dhe materiale te nevojshme per kopeshitin me dreke Bashkia Divjake", me fond limit total 1,892, 880 lekë pa TVSH.

- Vërtetim për realizim kontrate, Nr. 2738Prot., datë 08.06.2017, lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Divjake.

- Faturë Tatimore Shitje me nr serie 44691167, datë 02.05.2017, bashkangjitur dhe preventivi, shitës "Trinity Trade Company" sh.p.k. dhe blerës Bashkia Divjake.

9. Kontratë Nr. 1879/2 Prot., datë 25.10.2018 lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor Universiteti Aleksandër Xhuvani dhe operatorit ekonomik "Trinity Trade Company" sh.p.k. me objekt "Furnizim Malli", me fond limit total 337,000 lekë pa TVSH.

- Faturë Tatimore Shitje me nr serie 71682603, datë 22.11.2018, bashkangjitur dhe preventivi, shitës "Trinity Trade Company" sh.p.k. dhe blerës Universiteti Aleksandër Xhuvani.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;"

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..."

III.1.5. Në nenin 27, pika 3 të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, "Kontratat e Mallrave", parashikohet se "Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve".

III.1.6. Në nenin 27, pika 4 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar parashikohet se "Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon: - Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor

kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. - Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. - Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.1.7. KPP sqaron se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.8. Gjithashtu, kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me fushën e veprimtarisë së objektit të prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Sa më sipër, autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatët, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara.

III.1.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik "Trinity Trade Company" sh.p.k. në përmbushje të kriterit për eksperiencë të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, **1. Kontratë Nr. ---- Prot., datë 28.12.2018** lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor *Qendrës së grumbullimit dhe trajtimit të kimikateve të rrezikshme, Elbasan* dhe operatorit ekonomik "Trinity Trade Company" sh.p.k. me objekt "Blerje paisje të mbrojtjes individuale etj, për nevojat e Q.G.T.K.RR., Elbasan", me fond limit total 967.640 lekë pa TVSH; **2. Kontratë Nr. 2773/18 Prot., datë 16.02.2017** lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor *Posta Shqiptare sh.a* dhe operatorit ekonomik "Trinity Trade Company" sh.p.k. me objekt "Per blerjen shiritave plastikë për thasët me numerator dhe thaës", me fond limit total 3.321.252 lekë pa TVSH; **3. Kontratë Nr. 1837 Prot., datë 27.06.2016** lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor *Autoriteti Portual Durrës* dhe operatorit ekonomik "Trinity Trade Company" sh.p.k. me objekt "Pajisje special për FSPD", me fond limit total 1,621.000

lekë pa TVSH;. 4. Kontratë Nr. 4014/10 Prot., datë 15.02.2018 lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor *Posta Shqiptare sh.a* dhe operatorit ekonomik *“Trinity Trade Company” sh.p.k.* me objekt Loti II *“Blerje Thasë”*, me fond limit total 4.178.964 lekë pa TVSH;. 5. Kontratë Nr. 1846 Prot., datë 19.04.2017 lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor *Bashkia Divjakë* dhe operatorit ekonomik *“Trinity Trade Company” sh.p.k.* me objekt *“Blerje pajisje dhe materiale te nevojshme per kopeshitin me dreke Bashkia Divjake”*, me fond limit total 1,892,880 lekë pa TVSH;. 6. Kontratë Nr. 1879/2 Prot., datë 25.10.2018 lidhur ndërmjet autoritetit kontraktor *Universiteti Aleksandër Xhuvani* dhe operatorit ekonomik *“Trinity Trade Company” sh.p.k.* me objekt *“Furnizim Malli”*, me fond limit total 337,000 lekë pa TVSH;. 7. Faturë Tatimore Shitje me nr serie 44691186, datë 08.11.2017, bashkangjitur dhe preventivi, shitës *“Trinity Trade Company” sh.p.k.* dhe blerës *W. Center*;. 8. Faturë Tatimore Shitje me nr serie 44691187, datë 21.11.2017, bashkangjitur dhe preventivi, shitës *“Trinity Trade Company” sh.p.k.* dhe blerës *W. Center*;. 9. Faturë Tatimore Shitje me nr serie 44691190, datë 24.01.2017, bashkangjitur dhe preventivi, shitës *“Trinity Trade Company” sh.p.k.* dhe blerës *W. Center*. Nga verifikimi i kryer, KPP konstaton se me anë të dokumentacionit të mësipërm të dorëzuar, ankimuesi ka dëshmuar se nga ana e tij janë kryer furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit. Mallrat objekt prokurimi të kërkuara nga autoriteti kontraktor janë veshje uniforma mallra industrial, me sasi të përkatëse për çdo produkt. Referuar objektit dhe preventivave të kontratave të mësipërcituara rezulton se këto kontrata janë të realizuara me sukses dhe në përputhje me afatet e përcaktuara. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se referuar dëshmimeve të eksperiencës së mëparshme të dorëzuar dhe të realizuara ankimuesi ka provuar se ka furnizuar mallra të cilat për nga natyra janë të ngjashme me objektin e procedurës së prokurimit. Sa më sipër, KPP, konstaton se, me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik ankimues ka plotësuar kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në shtojcën nr. 8/2, pika 2.3.a. *“Kapaciteti teknik”* të dokumentave të tenderit për sa i përket eksperiencës së ngjashme. KPP gjykon se për të plotësuar pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim për eksperiencën e ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet dhe jo kontrata të njëjta, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimit por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në këtë kuptim, Autoriteti kontraktor nuk duhet të gjykojë në mënyrë sipërfaqësore e formale, por të analizojë në themel dhe në mënyrë të arsyeshme e proporcionale eksperiencat e dokumentuara nga ofertuesit/kandidatët, në funksion të qëllimit dhe rrethanave faktike për të cilin vendosen kriteret e përcaktuara. Në rastin konkret, Komisioni gjykon se eksperiencat e ngjashme të paraqitura nga operatori ekonomik ankimues jo vetëm për nga krahasueshmëria e kontratave janë të ngjashme por edhe për nga natyra e kontratës pasi janë kontrata mallrash, por edhe për sa i përket elementëve konkretë të mallrave të furnizuara KPP gjykon se me, anë të dokumentacionit të dorëzuar në SPE, ankimuesi ka vërtetuar se ka kryer me sukses, furnizime të ngjashme në përputhje me objektin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues *“Trinity Trade Company”* shpk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Trinity Trade Company” shpk për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-29384-07-04-2019, me objekt: “Blerje uniforma për Policinë Bashkiake”, me fond limit 1,563,000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 17.07.2019, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Trinity Trade Company” sh.p.k dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë ofertues.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vëre në dijëni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Trinity Trade Company” sh.p.k
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 1356 Protokoli, Datë 02.08.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

NënKryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha